



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim**

<b>Datë:</b>	12.03. 2018
<b>Për:</b>	<b>Imri Ahmeti, Kryetar i komunës</b>
<b>Nga</b>	<b>Nazim Gashi , Drejtor i DMSH</b>
<b>Lënda</b>	<b>Raport mujor për muajin Shkurt 2018</b>

Drejtoria për mbrojtje dhe Shpëtim sikur edhe muajve tjerë edhe në fillim të muajit shkurt në baz të planit vjetor ka hartuar planin mujor të punës për muajin Shkurt 2018.

Me që kompetenca për dhënjen e pëlqimit për masat mbrojtëse nga zjarri kanë kaluar në MPB gjegjësisht në sektorin e AME së ,jan pranuar një numër i konsiderueshëm i kërkesave për dhënjen e pëlqimit dhe të gjitha kërkesat janë proceduar për MPB gjegjësisht AME .

Gjithëshejt janë bërë pagesat të cilat kanë qenë obligim nga proceduar e doganimit ,homologimit dhe kontrollit teknik për autmjetin i cili është donacion nga Republika e Finlandës.

I jemi përgjegjës të gjitha thirrjeve dhe kërkesave që kanë arritur nga qytetarët ,SHPK apo institucione të tjera që kanë të bëjnë me rreziqet e ndryshme.

Gjat muajit Shkurt kemi pas një numër të konsiderueshëm të intervenimeve të ndryshme në terren sip.sh. zjarrefikje, intervenime teknike (zhbllokim të ashensorve ,largim të drunjëve të thyer të cilët kanë shkaktuar pengesë në qarkullim të qytetarëve apo automjeteve etj), pastrim i rrugëve pas aksidenteve ,intervenim i drejtpërdrejt në aksident për nxjerrjen e personave të aksidentuar etj.

Më poshtë po paraqesim formën tabelare të intervenimeve gjat muajit Shkurt të ndarë në javë dhe lloje të intervenimeve

